



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



DËSHTON EDHE PËRPPJEKJA E 25 PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT TË KOSOVËS

FAQE 4-5



Ka dështuar sërish të hënën konstituimi i Kuvendi i Kosovës edhe në tentativën e 25, pasi sërish nuk mori votat e mjaftueshme për formimin e Komisionit për

Votim të Fshehtë për zgjedhjen e kryeparlamentarit. Nga 104 deputetë që ishin në sallë, 51 deputetë votuan për, një kundër dhe s'pati abstenim.

Kryesuesi i seancës, Avni Dehari, ka njoftuar se seanca ndërpritet për shkak të mungesës së kuorumit dhe do të vazhdojë më 4 qershor në orën 10:30

NGA FAKTET QË JANË ZBULUAR TASHMË, MUND TË NGRIHEN DISA HIPOTËZA MBI KOMPLOTTIN MBI TË CILIN PUNON DHE ËSHTË NGRITUR GJYKATA SPECIALE



Shkruan: Milazim KRASNIQI

EKSPERTI I DREJTËSISË TRANZICIONALE: SPECIALJA U KRIJUA PËR INTERESAT E SERBISË



BIZNESET E MËDHA KALOJNË NË TREGUN E HAPUR TË ENERGJISË

“ATY KU KISHTE PRODHIM, SOT KA DRY”, ILIR IBRAHIMI ALARMON PËR KRIZËN EKONOMIKE NË VEND

RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepcisht - Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

SPORT

BEKA DHE KORENICA: DUAM T'I FITOJMË DY NDESHJET MIQËSORE

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com

info@kolegjbiznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A

DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Ukraina dhe Rusia përfundojnë bisedimet në Stamboll, pajtohen për këmbim të të burgosurve

STAMBOLL, 2 QERSHOR - Rusia dhe Ukraina e kanë përfunduar raundin e dytë të negociatave në Stamboll, që ka zgjatur pothuajse një orë, një ditë pas sulmeve masive ukrainase me dronë në bombarduesit strategjikë të Rusisë me kapacitet bërthamor.

Bisedimet e dyta direkte mes dy palëve prej vitit 2022 kanë nisur të hënën me dy orë vonesë, por arsyeja nuk dihet.

Disponimi në Rusi ka qenë i zymtë në nisje të bisedimeve, pasi blogerë rusë me ndikim për çështje të luftës, i kanë bërë thirrje Moskës të hakmerret kundër Kievit pas sulmeve që ka nisur Ukraina një ditë më parë.

Ukraina dhe Rusia i kanë përshkruar ndryshe-ndryshe dëmet e shkaktuara nga sulmi ukrainas, mirëpo nga pamjet është bërë e qartë se Moska është përballur me dëmtim të konsiderueshëm në pajisje. “Syte e gjithë botës janë fokusuar në

kontaktet këtu”, ka thënë ministri i Jashtëm turk, Hakan Fidan, duke iu referuar delegacioneve ruse dhe ukrainase, teksa ato janë ulur përballë njëra-tjetrës në një pallat afër Bosforit.

Ai ka thënë se qëllimi i takimit ka qenë vlerësimi i kushteve për armëpushim, diskutimet për një takim të mundshëm mes presidentëve të Rusisë dhe Ukrainës, dhe për të parë se cilat janë mundësitë për këmbim të të burgosurve.

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelenskiy, duke folur nga Lituania, ka thënë se dy palët janë duke u përgatitur për këmbim të ri të të burgosurve të luftës.

Shefi i stafit të Zelenskyt ka thënë se delegacioni ukrainas ka dorëzuar një listë me emra të fëmijëve të dëbuar drejt Rusisë, dhe dëshiron që ata të kthehen nëpër shtëpitë e tyre në Ukrainë. Zyrtarët ukrainas deklarojnë vazhdimisht se janë qindra



fëmijë që janë larguar nga territori ukrainas, dhe ata insistojnë që kthimi i tyre të jetë pjesë e marrëveshjes për paqe.

Moska, në anën tjetër, deklaroi se fëmijët janë shpërngulur për t'i mbrojtur nga luftimet. Departamenti amerikan i Shtetit ka thënë se sekretari i Shtetit, Marco Rubio, ka folur përmes telefonit me homologun e tij rus, Sergei Lavrov, më 1 qershor, për të diskutuar rreth bisedimeve të

së hënës.

Sipas DASH-it, telefonata u zhvillua me kërkesën e Rusisë, dhe Rubio ka përsëritur thirrjen e presidentit Donald Trump për bisedime të vazhdueshme të drejtpërdrejta për “arritjen e një paqeje të qëndrueshme”.

Para bisedimeve Ukraina u duk se forcoi pozicionin e saj negociues, pasi forcat e saj goditën disa aeroplanë bombardues nëpër Rusi, me

dronë që u futën tinëz në vend përmes disa kamionëve, dhe më pas u lëshuan nga lokacione të afërta.

Shërbimi i Sigurisë i Ukrainës (SBU) tha se të paktën 40 bombardues mund të jenë goditur gjatë sulmit të 1 qershorit, i përshkruar si “rezultat absolutisht i shkëlqyeshëm” nga presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, i cili shtoi se janë dashur mbi një vet e gjysmë për përgatitjen e operacionit.

Ukraina është pajtuar në prill për një armëpushim 30-ditor, sipas një propozimi nga ShBA-ja, por Rusia nuk ka shfaqur gatishmërinë për ta nënshkruar, dhe shumë prej aleatëve të Ukrainës e kanë akuzuar presidentin rus, Vladimir Putin, se po përpiqet ta zvarrisë procesin, në mënyrë që ta shfrytëzojë situatën aktuale në fushëbetejë, ku Rusia ka përparuar në territoret që synon t'i mbajë të pushtuara.

ShBA-ja i dërgon Iranit një propozim për marrëveshje bërthamore

UASHINGTON, 2 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara i kanë dërguar Iranit një propozim për marrëveshje bërthamore, që Shtëpia e Bardhë tha se është “e pranueshme” dhe është “në interesin më të mirë” të Teheranit që ta pranojë, raportuan mediet amerikane më 1 qershor.

Raportimet për këtë propozim vijnë pas një raporti të Kombeve të Bashkuara që tha se Republika Islamike ka rritur prodhimin e pasurimit të uranimit në nivele të larta.

Ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araghchi, tha se atij i janë paraqitur “elemente të një



propozimi të ShBA-së” nga homologu i tij nga Omani gjatë vizitës së tij në Teheran të shtunën. “I dërguari [i ShBA-së,

Steve] Witkoff ka dërguar një propozim të hollësishëm dhe të pranueshëm te regjimi iranian dhe është në interesin më të

mirë të tyre që ta pranojnë”, tha zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt, raportoi “New York Times”.

Propozimi është përshkruar si një seri pikash kyç, e jo si një draft i plotë, sipas “New York Times”, që ka cituar zyrtarë që kanë njohur me këtë këmbim diplomatik.

Propozimi i bën thirrje Iranit ta ndalë të gjithë pasurimin e uranimit dhe propozon krijimin e një grupi rajonal për të prodhuar energji bërthamore, grup që përfshin Iranin, Arabinë Saudite dhe shtete të tjera arabe, si dhe ShBA-në.

Irani ka mbajtur pesë raunde bisedimesh me ShBA-në në kërkim të një marrëveshjeje të re që do ta zëvendësonte marrëveshjen me fuqitë bërthamore, nga e cila presidenti amerikan, Donald Trump, u tërhoq gjatë mandatit të tij të parë presidencial më 2018.

Araghchi tha të shtunën se Irani i konsideron armët bërthamore “të papranueshme”. Këto deklarata ai i bëri një ditë pasi Trumpi tha se Irani “nuk mund të ketë armë bërthamore”, teksa u shpreh që shpreson që së shpejti të arrihet një marrëveshje.

Euroskeptiku Nawrocki fiton zgjedhjet presidenciale në Poloni

VARSHAVË, 2 QERSHOR - Kandidati nationalist opozitar, Karol Nawrocki, ka fituar raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale në Poloni me 50.89 për qind të votave, sipas komisionit të zgjedhjeve, duke i dhënë një goditje agjendës reformuese të qeverisë proevropiane të Polonisë.

Rivali i tij, Rafal Trzaskowski, kryetar liberal i Varshavës dhe aleat i qeverisë së udhëhequr nga Donald Tusk, mori 49.11 për qind të votave, raporton “Reuters”.

Një ‘exit poll’, të dielën, e kishte paraparë Trzaskowskin fitues.

Nawrocki, 42-vjeçar, historian

euroskeptik, i cili kishte udhëhequr një institut përkujtimor, ka bërë fushatë duke premtuar se do të siguronte që politikat ekonomike dhe sociale do t'i favorizonin polakët karshi nacionaliteteve të tjera, përfshirë refugjatët nga Ukraina fqinje.

Boksieri amator fitoi pavarësisht se e kaluara e tij dominoi ditët e fundit të fushatës presidenciale, nga pyetjet për blerjen e një banese nga një pensionist, deri te pranimi se ai kishte marrë pjesë në përlëshje të orkestruara.

Përderisa Parlamenti i Polonisë ka më së shumti pushtet, presidenti mund t'u vërë veton ligjeve,

ndërsa votimi u përcoll me interesim në Ukrainë, si dhe në Rusi, në Shtetet e Bashkuara dhe në Bashkimin Evropian.

Nawrocki, i mbështetur nga partia Ligj dhe Drejtësi (PiS), pritet t'i vazhdojë politikat e paraardhësit të tij, presidentit Andrzej Duda, po ashtu aleat i partisë më të madhe opozitare, përfshirë bllokimin e çfarëdo përpjekjeje nga qeveria për ta lejuar abortin apo për reformimin e gjyqësorit.

Në medie sociale, Duda falënderoi polakët për pjesëmarrje të madhe në zgjedhje. Dalja në votime ishte



71.31 për qind, tha komisioni i zgjedhjeve, që përbën rekord për balotazhin presidencial. “Ju faleminderit që morët pjesë në zgjedhjet presidenciale! Që dolet.

Që kryet obligimin tuaj qytetar. Që morët përgjegjësinë për Poloninë. Urime fituesit! Qëndro e fortë, Poloni!”, shkroi Duda në rrjetin social X.

EKSPERTI I DREJTËSISË TRANZICIONALE: SPECIALJA U KRIJUA PËR INTERESAT E SERBISË



PRISHTINË, 2 QERSHOR - Gjykata Speciale është një institucion politik që nuk do të sjellë drejtësi dhe e vetmja gjë që do të bëjë është t'i forcojë nacionalistët serbë që duan ta ndryshojnë narrativën për vitet 1990-1999, thotë në një intervistë për "KosovaPress", eksperti i drejtësisë tranzicionale, Aidan Hehir. Hehir, studiues i drejtësisë tranzicionale, intervenimit humanitar dhe shtetndërtimit në Kosovë nga Universiteti Westminster në Angli, thekson se procesi i atij që njihet si "gjqyqi i madh" në Hagë është tejzgatur. Ish-eprorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi ndodhen në paraburgim në Hagë prej nëntorit të vitit 2020. Zyra e Prokurorit të Specializuar i ngarkon Thaçin dhe të tjerët me akuza për krime të pretenduara të luftës. Ata janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës. Gjykimi ndaj tyre nisi më 3 prill 2023, gati tri vjet pas konfirmimit të aktakuzës prej kur ish-krerët e UÇK-së

mbahen në qendrën e paraburgimit në Hagë. "Po, me një fjalë [procesi në Hagë është tejzgatur]. Kjo ishte një gjykatë që u krijua në vitet 2014-2015. Është ende duke funksionuar sot. Është një gjykatë që nuk duhej të ishte themeluar kurrë. Asaj i mungon gjëja më e rëndësishme: legjitimiteti vendor. Është një gjykatë që iu imponua Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare. Në kohën kur u krijua, Hashim Thaçi vetë tha: 'Po i inkurajoj njerëzit të votojnë për themelimin e kësaj gjykate, jo sepse unë dua ta krijoj, por sepse më kanë thënë që duhet ta krijoj'. Kjo është shtrëngesë. Kjo është bashkësia ndërkombëtare duke e detyruar një shtet sovran, qeverinë e një shteti sovran, parlamentin e një shteti sovran, të krijojë një gjykatë. Dhe pse? Pse u krijua kjo gjykatë? Nuk duhet të jesh ndonjë gjeni apo teoricien konspirativ për ta kuptuar pse. Ajo u krijua për të pajtuar Serbinë. Për t'i thënë Serbisë: shih, po ju japim këtë", thotë Hehir. Ai shton se Serbia e donte

qartë krijimin e kësaj gjykate sepse dëshiron ta ndryshojë narrativën për vitet 1990. "Dëshiron të krijojë një mekanizëm të vazhdueshëm ku shqiptarë të Kosovës të gjykohen për krime kundër njerëzimit, një proces që do të zgjasë për vite e vite. Kjo i përshtatet narrativës së tyre për luftën, që thotë se kishte dy palë që u përfshinë në një luftë civile dhe që bënë gjëra të tmerrshme. Narrativa që thotë: 'ata janë po aq të këqij sa ne'. Pra, e vetmja arsye për krijimin e gjykatës ishin interesat serbe", tha Hehir. Dhomat e Specializuara janë pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por veprojnë me personel ndërkombëtar në Hagë të Holandës. Bashkimi Evropian është financuesi kryesor i Gjykatës Speciale e cila u themelua në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës pas kërkesës së bashkësisë ndërkombëtare. Në këtë gjykatë kontribuojnë edhe shtete të treta: Shtetet e Bashkuara, Zvicra, Kanadaja, Norvegjia dhe Turqia. Ndërkaq, Shtetet e Bashkuara japin kontributin e tyre duke financuar punonjës të

emëruar nga ajo. Specialja është kritikuar në vazhdimësi për redaktime të shumta dhe mbyllje për publikun. Edhe Avokati i Popullit i Kosovës, Naim Qelaj, ka shprehur shqetësime rreth punës së Gjykatës Speciale. Qelaj ka ngritur dyshimet e tij nëse në Speciale po respektohen parimet e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm. Profesori Hehir thotë se pikërisht për shkak të mungesës së transparencës, në Kosovë ka mendime krejtësisht negative për këtë institucion. "Është një institucion thellësisht politik, i krijuar për arsye politike, dhe ekzistenca e saj, ashtu si edhe ekzistenca e UNMIK-ut dhe e EULEX-it në Kosovë, dëshmon se komuniteti ndërkombëtar nuk po punon domosdoshmërisht në interesin e Kosovës në çdo rast... Kjo gjykatë është thjesht, siç thashë, një trup politik që nuk do të sjellë drejtësi. E vetmja gjë që do të bëjë është t'i forcojë nacionalistët serbë që duan ta ndryshojnë narrativën për vitet '90", thotë Hehir.

Një muaj më parë Zyra e Prokurorit të Specializuar e ka përfunduar çështjen e saj në rastin Thaçi dhe të tjerët. Kundër ish-eprorëve të UÇK-së kanë dëshmuar 125 dëshmitarë në sallën e gjyqit dhe janë deponuar mijëra faqe me dokumente si prova materiale. Avokatët mbrojtës tashmë kanë njoftuar për mocionet e tyre për rrëzimin e akuzave. Ajo çfarë tashmë dihet është se nëse mocionet e avokatëve mbrojtës rrëzohen, ata do të thërrasin disa dëshmitarë. Mbrojtja e ish-eprorëve të UÇK-së e ka konsideruar rastin e prokurorisë të dobët si dhe ka deklaruar se presin rezultat pozitiv në fund të këtij procesi gjyqësor. Gjykata Speciale deri më tash ka shqiptuar dy aktgjykime fajësie për krime të pretenduara të luftës si dhe të tjera kundër administrimit të drejtësisë. "Kjo gjykatë është nominalisht një gjykatë e Kosovës, por ndodhet në Hagë, kështu që në themel është një gjykatë e çuditshme, por është ndryshe në përbërjen ligjore nga TPNJ-ja", thotë Aidan Hehir.

Kthehet "Gjarpri i shtëpisë" në Burojën e Hashim Thaçit

SKENDERAJ, 2 QERSHOR - Në Burojë të Drenicës hasen shpesh rojet e shtëpisë (gjarpri i shtëpisë -

bolla). Një të tillë e ka xhiruar Bujar Shala, mbi dy metra i gjatë. Ato janë simbole të besimit ilir për

shkak të rojës që bëjnë. Nëse zhduket/arratiset nga shtëpia, pritet bela që zgjatë, sipas atij

besimi. Shfaqja duket ogur i mbarë në Burojën e Hashim Thaçit.





DËSHTON EDHE PËRPPJEKJA E 25 PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT TË KOSOVËS

Ka dështuar sërish të hënën konstituimi i Kuvendi i Kosovës edhe në tentativën e 25, pasi sërish nuk mori votat e mjaftueshme për formimin e Komisionit për Votim të Fshtehtë për zgjedhjen e kryeparlamentarit. Nga 104 deputetë që ishin në sallë, 51 deputetë votuan për, një kundër dhe s'pati abstenim. Kryesuesi i seancës, Avni Dehari, ka njoftuar se seanca ndërpritet për shkak të mungesës së kuorumit dhe do të vazhdojë më 4 qershor në orën 10:30

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Për të njëzetepestën herë me radhë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar të hënën ta konstituojnë përbërjen e nëntë parlamentare, të dalë nga zgjedhjet e shkurtit. Ligjbërësit refuzuan për të shtatëmbëdhjetën herë rresht ta formonin një komision për mbikëqyrjen e një votimi të fshtehtë për kreun e ri të organit ligjvënës. Çështja e votimit të fshtehtë - që u propozua më 1 maj nga kryesuesi i seancës, Avni Dehari, pasi e propozuara e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, nuk arriti në disa votime t'i merrete 61 votat e nevojshme për t'u konfirmuar në post - është dërguar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga

partitë që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë. Ato thonë se është jokushtetuese mënyra se si LV-ja po tenton që kryeparlamentari të votohet përmes formës së fshtehtë dhe i kanë kërkuar Kushtetueses të marrë "një masë të përkohshme për ndalim të mbajtjes së seancave, derisa me prioritet ta trajtojë këtë lëndë dhe ta marrë një vendim". Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe refuzuan sërish, në vazhdimin e seancës konstituive më 2 qershor, ta propozonin një përfaqësues që do ta siguronte mbarëvajtjen e votimit të fshtehtë. Seanca konstituive do të vazhdojë të mërkurën e 4 qershorit. Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të

agjendës së seancës konstituive: raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe atë të Betimit të Deputetëve. Procesi ka ngecur te pika e tretë: zgjedhja e kryeparlamentarit. Haxhiu e LV-së po konsiderohet figurë përçarëse nga dy parti parlamentare: PDK-ja dhe AAK-ja. Këto dy subjekte kanë kërkuar që LV-ja të nxjerrë emër tjetër për kryeparlamentar. LDK-ja, ndërkaq, ka thënë se nuk ka vota për asnjë të propozuar të LV-së për pozitën e kryeparlamentarit. Propozimi për kryeparlamentar është e drejtë ekskluzive e fitueses së zgjedhjeve, LV-së, e cila ngul këmbë se Haxhiu e meriton të zgjidhet dhe, ndonëse ka kërkuar marrëveshje politike me partitë e tjera, e ka përjashtuar mundësinë të sjellë kandidat tjetër pos saj. Deputetët duhet ta zgjedhin kryetarin dhe pesë nënkryetarët për ta konstituuar përfundimisht Kuvendin e ri. Vetëm pas konstituimit të Kuvendit mund të formohet qeveria e re.

Haxhiu: Opozita inat irracional, më quan përçarëse

Ministrja në detyrë, njëherësh kandidate për kryeparlamentare, Albulena Haxhiu, ka folur pas dështimit të konstituimit të Kuvendit të Kosovës. Ajo para medieve ka

thënë se partitë opozitare me një inat irracional kanë vendosur të mos marrin pjesë në votim. Gjithashtu, Haxhiu foli edhe për kërkesën e AAK-së të cilën e kanë dërguar në Kushtetuese. "Sot bëhen tri javë prej kur AAK e ka dërguar këtë çështje në Kushtetuese. Ata e kanë kontestuar formimin e këtij komisioni. Uroj që Kushtetuesja të veprojë në raport me rrethanat". E pyetur për deklaratat e deputetëve të cilët e kanë quajtur "përçarëse", ajo tha: "Mendoj që edhe Kurti ka folur mbi këtë çështje. Ajo që dëshiroj të shtoj, siç e kam thënë në të kaluarën, nuk i kuptoj ato deklarata që i ka bërë opozita, duke më quajtur përçarëse... asnjëherë nuk kam vepruar në kundërshtim me interesat e Republikës së Kosovës. Sulmet seksiste dhe mizogjene kanë qenë të papranueshme për mua, por edhe për çdo grua që do të merrej me politikë", tha ajo, duke shtuar se këto sulme i dekurajojnë gratë e tjera që të marrin pjesë në pozita udhëheqëse.

Çitaku: Jemi në një fazë të rrezikshme

Deputetja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se vendi është një fazë të rrezikshme. "Kemi hyrë në një fazë të rrezikshme për vendin. Ekonomia po dëmtohet dhe po rrezikohet. 140 mijë punëtorë po rrezikohen, familjet tona po rrezikohen e në ndërkohë Kuvendi dhe

institucionet vazhdojnë të mbesin të bllokuara për shkak të kryeneçësisë së grupit të parë parlamentar", ka thënë Çitaku. Ajo u shpreh se Kosova është më e madhe se secili prej nesh. "Edhe njëherë bëjmë ftesë për reflektim. Kosova është më e madhe se secili prej nesh", ka deklaruar Çitaku.

Haziri: Nuk është problem i LDK-së nëse Kurti s'mund ta bëjë qeverinë

Deputeti i LDK-së, Lufti Haziri, ka thënë se situata është e njëjtë dhe se mungesa e një vullneti politik për të gjetur një zgjidhje të shpejtë politike është bërë e pavlefshme për ta përmendur. "Jemi vonë. Është bërë neveritëse për qytetarët dhe vetë ne. Ka rrugë e mundësi që duhen për t'u shtjerr deri në fund. Për LDK-në nuk ka të bëjë emri i përveçëm, por parimi që konstituimi të finalizohet, dhe një marrëveshje politike është përtej urgjencës sepse Kosova është në krizë politike", është shprehur Haziri. Ai ka thënë se kryeministri në detyrë, Albin Kurti, nuk po punon për zhbllokim të Kuvendit. "Nëse i duhet zonja Haxhiu si arsytim për shkak se nuk po mund ta formojë qeverinë, është problem i tyre, jo i yni", ka thënë Haziri, duke shtuar se Kurti ka bërë fushatë negative dhe ka lënduar kolektivisht.

LETËR PUBLIKE LIDERËVE TË PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË

THIRRJE PËR UNITET POLITIK DHE FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS PAS ZGJEDHJEVE



Shkruan:
Arsim BAJRAMI

Si një prej pjesëmarrësve aktiv në të gjitha proceset e shtetndërtimit të Kosovës nga viti 1990 e deri në vitin 2017, si anëtar i rregullt i Akademisë Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK), Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave (ASHASH), dhe Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve (EASA), shpreh shqetësimin tim për situatën aktuale në vend. Kjo situatë karakterizohet nga mungesa e formimit të institucioneve qeverisëse pas zgjedhjeve të fundit, të cilat tani e tre muaj po zvarriten pa një

marrëveshje përbashkët mes partive politike. Çdo vonesë e mëtejshme në konstituimin e kuvendit me abuzimet kushtetuese, po zbehë aftësitë tona qeverisëse dhe po tregon paafësinë tonë shtetndërtuese. Vlerësoj se kjo periudhë paszgjedhore duhet të shërbejë si një moment reflektimi dhe bashkëpunimi mes të gjitha partive politike për të arritur një konsensus të domosdoshëm. Kosova është përballur me sfida të shumta dhe kërkon një angazhim të përbashkët për t'i bërë ballë atyre. Partitë politike duhet të angazhohen në një dialog konstruktiv, i cili do t'i shty ato të tejkalojnë dallimet dhe të

arrijnë një marrëveshje të ndërsjellë për përfaqësimin dhe drejtimin e vendit. Formimi i institucioneve është një detyrë e domosdoshme për funksionimin e shtetit dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës. Këto institucione përfaqësojnë vullnetin e qytetarëve dhe janë thelbësore për stabilitetin demokratik. Një qeverisje e fortë dhe e qëndrueshme është e nevojshme për t'u përballur me sfidat ekonomike, sociale dhe politike që po e prekin vendin. Pa një qeverisje të fuqishme, rreziku i pasigurisë dhe mosbesimit në institucione rritet, çka mund të ketë pasoja të rënda për të gjithë shoqërinë kosovare. Në këtë moment të rëndësishëm për shtetin tonë, ne jemi të detyruar të krijojmë një unitet të nevojshëm politik mes të gjitha partive dhe liderëve të politikës. Kosova po përballlet me sfida të shumta, dhe është koha që të bashkojmë forcat tona për t'i përballuar ato me sukses. Kjo është një domosdoshmëri në momentet kur rendi i ri botëror po ndryshon me shpejtësi të paparashikueshme. Po kalojmë në faza kritike të rikonfigurimit politik në botë, ku vetëm me një unitet të partive politike në çështje

shtetërore, Kosova mund të rreshtohet drejt përballjes me sfidat me të cilat po përballlet. Uniteti politik është themelor për stabilitetin dhe zhvillimin e vendit tonë. Bashkëpunimi ndërpartiak nuk është vetëm një alternativë, por një domosdoshmëri që do të ndihmojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe forcimin e institucioneve tona. Me këtë rast, partitë politike parlamentare dhe liderët e tyre duhet të ulen së bashku, pa dallim ideologjie, për të diskutuar rreth mundësive të themelimit sa më të shpejtë të institucioneve dhe bashkëveprimit për zgjidhjen e sfidave tona të përbashkëta. Për të realizuar shtetndërtimin, duhet të ruajmë miqtë, sepse rendi botëror po ndryshon. 17 vjet pas shpalljes së pavarësisë, Kosova ende nuk ka plotësuar misionin e saj të pavarësisë dhe vazhdon të përballlet me sfida në përmbylljen e procesit të shtetndërtimit dhe konsolidimin e sovranitetit tonë. Të dhënat historike na japin një pasqyrë të rëndësishme mbi unitetin dhe sukseset që kemi arritur si komb. Është e vërtetë se kur kemi vepruar së bashku, kemi arritur të fitojmë mbështetje nga partnerët tanë ndërkombëtarë, dhe proceset

si ai i Rambujesë dhe Vjenës dëshmojnë për potencialin e lidërshiptit tonë. Si një shtet që është formuar përmes sakrificave të mëdha, është thelbësore të ruajmë këtë unitet dhe të mos dështojmë në ndërtimin e shtetit tonë. Duhet të tregojmë forcë dhe vendosmëri, sidomos ndaj partnerëve tanë ndërkombëtarë, të cilët kanë mbështetur në momentet më të errëta, kur populli ynë ka përjetuar dhimbje të thella e kriminale nga ana e Serbisë. Vetëm me një plan të koordinuar dhe unitet të brendshëm mund të përcjellim mesazhe të forta dhe të sigurojmë një të ardhme më të ndritshme për të gjithë ne. Kosova ka humbur shumë kohë në përplasje të brendshme politike, ndërsa këto zgjedhje kanë krijuar një situatë kaotike, e cila mund ta vonojë edhe më tej përparimin e saj. Në kontekstin aktual ndërkombëtar, Kosovës nuk i lejohet vonesa në krijimin e institucioneve shtetërore. Sa më shpejt duhet të formohet një qeveri gjithëpërfshirëse, e cila duhet të përmbushë detyrimet e pranuar ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, të heqë sanksionet e padrejta ndaj shtetit tonë dhe të forcojë partneritetin euroatlantik të vendit tonë.

NGA FAKTET QË JANË ZBULUAR TASHMË, MUND TË NGRIHEN DISA HIPOTEZA MBI KOMPLOTTIN MBI TË CILIN PUNON DHE ËSHTË NGRITUR GJYKATA SPECIALE



Shkruan:
Milazim KRASNIQI

Nga faktet që janë zbuluar tashmë, mund të ngrihen disa hipoteza mbi komplotin mbi të cilin punon dhe është ngritur

Gjykata Speciale. E para, Gjykata Speciale duket se ka gjetur terren të përshtatshëm te pasioni i disa njerëzve e familjeve shqiptare për hakmarrje. Serbia e ka njohur mirë këtë dobësi shqiptare të

gjakmarrjes dhe e ka shfrytëzuar në maksimum, duke rekrutuar individë dhe familje me pasion hakmarrës ndaj figurave qendrore të UÇK-së. E dyta, si duket, janë përfshirë në dëshmi të rrejshme shumë persona që kanë qenë ose profitorë ose të shantazhuar. Faktori i tretë rezultoi në jetë korruptimi i hetuesve e prokurorëve të huaj. Faktor pasues me gjasë ka qenë edhe naiviteti i jo pak ish-luftëtarëve të UÇK-së, që kanë shkruar libra e ditar me gënjesht, që kanë folur mbarë e mbrapsht, duke i zmadhuar e deformuar ngjarjet. Dhe brenda kësaj është edhe naiviteti në rastin e publikimit të dosjeve të Gjykatës Speciale, të servuara nga qarqe, po ashtu, antishqiptare. Gjithsesi edhe

përçarja e faktorëve politikë është faktorë me ndikim në tërë këtë skenar ogurzi të armiqve të Kosovës. Natyrisht në themel të Gjykatës mbetet shantazhi që është bërë ndaj politikanëve e deputetëve për formimin e Gjykatës Speciale nga Qeveria e Partisë Demokratike të ShBA-së dhe nga shtete evropiane e struktura të BE-së, të cilat as që e njohin Kosovën si shtet. (Gjykata u ka shërbyer si arsye që ta heqin nga rendi i ditës çështjen e njohjes së Kosovës si shtet.) Dhe në fund është me peshë në këtë tregim të hidhur edhe manipulimi me sukses abnormal i opinionit publik nga propaganda intensive kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e krerëve të saj, gjë që e ka lehtësuar punën e të gjithë armiqve të Kosovës, të cilët me

Gjykatën Speciale synojnë të kompromentojnë e mbase edhe ta zhbëjnë shtetin e Kosovës. Të bërë bashkë të gjithë këta faktorë malinj, e rrezikojnë seriozisht jo vetëm legjitimitetin po edhe ekzistencën e Republikës së Kosovës. E sigurt është se nëse dënohen Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli e Rexhep Selimi për krime lufte, hapen dilema dramatike për shtetin e Kosovës: mund të ketë tërheqje të njohjeve, bllokim të njohjeve, përjashtim nga organizatat ndërkombëtare ku Kosova aderon, rebelim të serbëve lokalë, inkursion ushtarak nga Serbia, reagime iracionale të ndonjë pjesë të shqiptarëve dhe rrjedhimisht delegitimim-izolim, secesion-copëtim e demolim faktik të shtetit. Mbani mend!

MARATONA E KURTHIT DHE KURDISJES

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Për moralin dhe gjuhën seksiste: E pritshme që dështoi edhe raundi i 25 i një dueli të kurdisur ende pa u mbajtur zgjedhjet. Deputeti me betim si dhe KM pa mandat, Albin Kurthi pati kërkuar 500.000 zemra për ta përfunduar kapjen 100 për qind duke e lënë prapa edhe Korenë e Veriut. Nuk ia doli por, me nja 100 mijë stenta mund ta arrijë këtë numër. Skenarin bllokues e kishte bërë gati më herët duke ia caktuar rolin e marionetës deputetit më të moshuar në Kuvend. Ky deputet, në kundërshtim edhe të çdo dinjiteti minimal me besnikëri nënshtruese me asgjë nuk po e kundërshton rolin e marionetës. Deri në rrethin e 8 të Ferrit të Dante Aligerit. Pse ky deputet po sillet si marionetë, nuk është aspak e habitshme, është në shërbim të partisë dhe Liderit Suprem por nuk e kuptoj pse deputetja më e re në moshë e që ka rastisë të jetë nga radhët e PDK-së po pranon të bëhet marionetë e marionetës numër 1 - për faktin se, ndonëse sipas Rregullores së Kuvendit është e barabartë me kryesuesin, ajo nuk pyetet për asgjë. Ajo, në këto rrethana nuk e ka vendin afër marionetës numër 1 - por në mesin e deputetëve të partisë që i takon. Pra, marioneta numër 1 - po e përfundon misionin e paracaktuar dhe në skenë, ende pa u promovuar në postin e paracaktuar nga Lideri Suprem, deputeti me betim dhe KM pa mandat, Albin Kurthi, gjithashtu me qëllim bllokues në kohën e duhur, marioneta numër 2 - Lenka Haxhiu. Ndonëse po refuzohet nga opozita, marioneta numër 2 - është këmbëngulëse ta luaj rolin që i është caktuar nga partia dhe Lideri Suprem. Opozita e tashme ishte në lajthitje logjike kur mendonte dhe besonte se partia fituese dhe Albin Kurthi do të kalojnë



në opozitë duke e dorëzuar pushtetin pasi nuk po e kalojnë Rubikonin e Kuvendit. Kam qenë dhe jam i sigurt se këta kurrë dhe në asnjë rrethanë nuk e dorëzojnë pushtetin, qoftë edhe duke shkaktuar viktima fizike. Ambientin social e kanë helmuar me urrejtje të paparë deri më tani. Loja dhe qëllimi i pozitës ishte dhe është që opozita të fajësohet për bllokim të themelimit të Kuvendit. Kanë angazhuar një makineri të tërë, që nga RTK-ja apo Radio Televizioni i Kurthit, disa “opinionistë” nga shoqëria civile, pasardhës politikë të Arkanit, asi që lexojnë gazeta të huaja, Sputnikun dhe ato të Beogradit, në me krye prof. dr. Ramçen, një analfabet politik, patriot i tredhur dhe llaskuc ekzemplar i pushtetit. Realisht, as në Kosovë dhe në asnjë vend të botës opozita nuk ka asnjë detyrim t’i bëjë votat pozitës, në Kosovë më së paku nëse kemi parasysh trajtimin sadist që pozita i ka bërë opozitës. Ftesën që LV-ja i ka bërë LDK-së për koalicion mund ta konsiderojmë dhe është si “puthja e Judës” që Juda i ka bërë Krishtit, me bekimin e Pont Pilatit para se t’ua dorëzojë legjioneve romake. Më gjeni një detyrim ligjor që do të kërkonte që opozita të

bëjë vota për pozitën! Nuk e gjeni sepse nuk ka. Sa i përket detyrimit moral, opozita ka edhe më shumë arsye të mos ua bëjë votat për faktin se pozita moralin nuk e njeh as si kategori gjuhësore e as si psikologjike. Kur flasin për moral shkaku se nuk ua bëjnë votat disa deputetë të opozitës është aq në kundërshtim me moralin që as nuk ia vlen të diskutohet. Në anën tjetër për politikanë që shohin dy gishta larg hundës së Dimalit, e që në opozitën aktuale qartazi nuk ka të tillë, strategjikisht shumë do të fitonin nëse që në seancën e parë do ta votonin themelimin e Kuvendit dhe qeverinë Kurthi 3. Po të isha unë lider i partive opozitare, me vetëdije të plotë do t’i siguroja votat e nevojshme pastaj, nga opozita do të organizojë aktivitetet të fuqishëm opozitar, duke i përdorur të gjitha mënyrat që janë në dispozicion. Edhe pas këtij votimi eventual, pozita do të mbetej pakicë, do të varej nga votat e opozitës. Politikanët e mirëfilltë kështu e luajnë lojën, politikanët që e kanë interesin e çastit po e luajnë lojën që po luhet tani. Përrallat e marionetës numër 2, ende në përpjekje se është paqësore, se ka shërbyer për interes të shtetit (cilit shtet), dhe se ndaj saj

është përdorur gjuhë seksiste janë prapashitesë e Liderit Suprem që e quan opozitën patriarkale dhe primitive shkaku se seksi dhe seksualiteti qenkan pengesë për moskonstituim të institucioneve. Po ta thoshte këtë Komandant Pasuli, tashmë i licencuar kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht si rrenc patologjik, do të arsyetohej disi. Por kjo nuk iu lejohet Albin Kurthit dhe plejadës së intelektualëve analfabetë si, Akademik Bahtirit, mësje Nezir Krakovinës, Limoza el Gadafi - Radoiçiq, Hajnrrullah Çekos, Faton si Pecit, Donikë Katran Shvarcit, Haxhi Qamilit, narkomanëve të Prizrenit dhe “vlerave” tjera rrush të thartë të pushtetit. Po ta votonte opozita themelimin e Kuvendit dhe qeverinë Kurthi 3, Kurthi do të kapej në kurthat që vet i ka ngritur për të tjerët ndërsa opozita, duke qëndruar anash çdo ditë do të shënonte nga penalltia që ia mundëson pushteti. Po opozita nuk po sheh as një milimetër larg nga hunda e Dimalit e lëre më dy gishta. **Nisma e bukur, Nisma e ndershme dhe Nisma patriotike:** Fatmir Limaj, Komandant Bojleri sipas pozitës apo Komandant Çeliku si njihej

deri sot, është bërë fytyra më e përfolur, më e lakuar, më e pëlqyer dhe më patriotike e pozitës aktuale.....deri ta votojë Lenka Haxhiun. Pastaj, e kalova lumin, ta asisha Nisma-n. Fatmir Limaj tha se e kishte një premtim gojor (paradoksalisht, gojoret edhe të disponojnë, edhe të dëshpërojnë) nga Kurthi për postin e kryetarit të Kuvendit, pa një marrëveshje të nënshkruar. Po duket se ndodhi një gabim sepse emri Fatmir Limaj u bë Lenka Haxhiu. Limaj është driblues si Messi në mikrohapësirat ku ai fiton. Edhe këtu, deri më tani shumë mirë po luan. Për pushtet Kurthi bën çdo gjë, pavarësisht çmimit që duhet ta paguajnë të tjerët. Albin Kurthi nuk i beson “Komandant Bojlerit” se mund të bëhet marionetë sipas standardeve të përcaktuara nga Kurthi prandaj është mosbesues. Te Lenka nuk e ka asnjë dyshim prandaj është për Lenkën. Albin Kurthi nuk i beson asnjë luftëtari të UÇK-së, madje as luftëtarëve legjendarë si Cen Mishi dhe Lali i Cveklës. E lëre më Fatmir Limës. Ramiz Lladrovci është një parashikues i jashtëzakonshëm, ka paraparë saktë raportin e Limajt me AAK-në pas zgjedhjeve. Gjithashtu, Ramiz Nostradamusi ka paraparë se Limaj nuk do të jetë kryetar i Kuvendit por pjesë e qeverisë Kurthi 3. Kam mëdyshjet e mia. Ramizit po ia japë mundësinë e tretë, ose bëhet Nostradamusi nga Drenasi, ose bëhet si Spartak Ngjela që, deri më sot nuk i ka dalë asnjë parashikim i saktë avokatit patriot dhe idealist. Pyetje për Ramizin, a do të bëhet Albin Kurthi kryetar i ardhshëm i Bangladeshit pasi në popull qarkullon një thënie se: “U bë Kosova Bangladesh..”. Mendoj se nëse Nisma pranon të bëhet pjesë e qeverisë, iku përlesh. Nëse Fatmir Limaj bëhet kryetar i Kuvendi, është tregim tjetër. Mirëpo Kurthi nuk i beson Fatmiri, këtu qëndron problemi. As në variantin më të shëmtuar Fatmir Limaj nuk mund të bëhet si marioneta numër 1 dhe marioneta potenciale numër 2. E shohim.

Arrestohen 15 të dyshuar për lëshim të çeqeve pa mbulesë ose të rremë

GJILAN, 2 QERSHOR - Njësitë e Hetimeve të Përgjithshme nga Sektori i Hetimeve Rajonale në Gjilan, pas një hetimi intensiv rreth njëvjeçar, të hënën ka realizuar me sukses një operacion policor mirë të planifikuar dhe organizuar, që ka rezultuar me arrestimin e pesëmbëdhjetë personave të dyshuar. Arrestimi i tyre është bërë pasi gjatë hetimit janë siguruar dëshmi të arsyeshme se të dyshuarit kanë qenë të

përfshirë në veprat penale “Lëshim i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorim i kartelave të bankës apo të kreditit” dhe “Mashttrim kompjuterik”. Bazuar në informacionet dhe provat e mbledhura gjatë hetimit, të dyshuarit, dyshohet se në periudha të ndryshme kohore, me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm për vete dhe persona të tjerë, kanë përdorur të dhëna të ndryshme bankare, duke shkaktuar dëme

materiale për qytetarë. Operacioni është realizuar në koordinim dhe autorizim të Prokurorisë Themelore në Gjilan. Të gjithë të arrestuarit me vendim të prokurorit të shtetit janë dërguar në mbajtje për 48 orë. Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjilan ka njoftuar se mbetet e përkushtuar për identifikimin dhe arrestimin e personave që përmes mjeteve teknologjike cenojnë sigurinë financiare të qytetarëve.



Komandanti i FSK-së takon dy gjeneralë amerikanë, në fokus “Defender Europe 25”

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari, ka pritur në takim gjeneralmajor Michael E. Wegscheider, komandant i Divizionit të 28-të të Këmbësorisë së Ushtrisë Amerikane dhe gjeneralmajor Stephen Osborn, agjuntant i përgjithshëm i Gardës Kombëtare të Ajovës. Gjatë takimit të përbashkët, komandanti i FSK-së u uroi

mirëseardhje gjeneralëve amerikanë dhe i njoftoi për zhvillimet dhe të arriturat e fundit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke theksuar fushat e bashkëpunimit bilateral dhe aktivitetet e përbashkëta. Pastaj gjatë takimit u bisedua për pjesëmarrjen e FSK-së në ushtrimin e përbashkët shumëkombësh “Defender Europe 25”, ku FSK-ja merr pjesë në Kosovë si nikoqire, si dhe me kontingjentet e saj në

Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Kroaci. Po gjatë takimit u diskutua edhe mbështetja e ushtrisë amerikane në validimin e Ekipit 2 të ROL 1 si dhe për trajnimin e përbashkët në JRTC me Gardën Kombëtare të Ajovës. Në fund të takimit gjeneralët u zotuan për vazhdimin e zgjerimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme me interes të përbashkët.



OSMANI NDERON NËNAT E SREBRENICËS ME MEDALJE PRESIDENCIALE

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka ndarë Medalje Presidenciale për nënat e Srebrenicës të Bosnjë-Hercegovinës, aty ku në korrik të vitit 1995 janë vrarë më shumë se 8 300 boshnjakë nga forcat serbe. Masakra e Srebrenicës është cilësuar më e rënda në Evropë që prej Luftës së Dytë Botërore dhe njihet si gjenocid. Presidentja Osmani ka thënë se Srebrenica është një plagë e hapur në vetëdijen e botës, dhe është simbol i tragjedisë që ka shkundur vetëdijen globale, por që ende nuk e ka marrë drejtësinë që e meriton. Osmani e ka ndarë çmimin në kuadër të edicionit të tretë të Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, i cili ishte zotim i Kosovës në kuadër të Samitit për Demokraci, të



mbajtur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 2021. “Ne në Kosovë bashkëndejmë thellësisht me vuajtjen tuaj, sepse edhe ne kemi përjetuar të njëjtin gjenocid të bërë nga i njëjti agresor. Lista e masakrave

është e gjatë dhe e dhimbshme. Dhe tani, pas më shumë se dy dekadave prej kur ka përfunduar lufta, mijëra nga Kosova dhe Bosnjë-Hercegovinë vazhdojnë të jenë të zhdukur. Nënata nuk kanë një

varr ku të vajtojnë të dashurit e tyre, por vetëm heshtin, heshtje që godet çdo ditë”, ka thënë Osmani. Ajo ka thënë se e ndan çmim në emër të të gjithë shtetasve të Kosovës, dhe u është drejtuar nënave të Srebrenicës, duke u thënë se ato janë “frymëzim dhe simbol i forcës që buron nga dashuria amnore”. Ministri i Jashtëm i Bosnjë-Hercegovinës, Elmedin Konaković, ka thënë se është thellësisht i nderuar që nënat e Srebrenicës janë nderuar këtë vit me Medaljen Presidenciale, duke i përshkruar ato si simbol global i dinjitetit. “Këto gra kanë përjetuar dhimbjen dhe vuajtjen më të madhe njerëzore, por e kanë shndërruar në forcë dhe fuqi për drejtësi, kujtesë dhe paqe. Ato asnjëherë nuk kërkuar hakmarrje, vetëm të vërtetën”, ka thënë Konaković

gjatë paraqitjes së tij në Forumin e mbajtur në Prishtinë, në të cilin do të marrin pjesë 150 persona nga 45 shtete të botës. Në maj të vitit të kaluar Kombet e Bashkuara e kanë miratuar një rezolutë, e cila njuh 11 Korrikun si Ditë Ndërkombëtare të Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë. Deri më tani mbi 6 650 viktimat e gjenocidit janë varrosur në Qendrën Përkujtimore Potoçari. Më shumë se 1 000 persona të zhdukur janë ende në kërkim. Gjykata të ndryshme kanë dënuar deri tash më shumë se 50 persona, me më shumë se 700 vjet burg, për gjenocid dhe krime të tjera në Srebrenicë. Ish-udhëheqësi i serbëve të Bosnjës, Radovan Karaxhiq, është i dënuar me burgim të përjetshëm, ashtu si edhe ish-udhëheqësi ushtarak në Bosnjë, Ratko Mlladiq.

‘ATY KU KISHTE PRODHIM, SOT KA DRY’, ILIR IBRAHIMI ALARMON PËR KRIZËN EKONOMIKE NË VEND

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Drejtori i Klubit të Biznesit, Ilir Ibrahim, ka ndarë shqetësimin e tij për situatën ekonomike në vend që, sipas tij, po godet themeluesit e bizneseve në Kosovë. Ai thekson se nuk flet si përfaqësues i ndonjë shoqate biznesi, por si mik dhe si dëshmitar i një dhembjeje që po prek një shtresë të tërë të shoqërisë. “Rrallë më ka rastisur të mbetem pa fjalë dhe të mos gjej asnjë shprehje ngushëllimi kur një mik të merr në telefon

dhe të thotë se sot e mbylli fabrikën”, shprehet Ibrahim, duke nënvizuar se shumë prej atyre që kanë kontribuar në ngritjen e ekonomisë vendore, sot ndihen të zhgënjyer dhe të braktisur. Ibrahim thekson se shkak i kësaj gjendjeje nuk është konkurrenca e jashtme apo ndonjë fatkeqësi natyrore, por “vendimi i shtetit të tyre - vendimi i atyre që duhej t'i mbronin - që po ua shuan motivin për të jetuar e punuar



këtu”. Sipas Ibrahimit, ky nuk është vetëm një moment i vështirë ekonomik, por një krizë më e thellë. “Sot po mbyllen dyert e

fabrikave që dikur gumëzhnin nga puna. Jo për shkak të dështimit, jo për mungesë vizioni apo për mungesë përkushtimi - por për shkak të një vendimi të paarsyeshëm, të marrë në zyrat e ftohta të pushtetit, larg realitetit të biznesit dhe larg njerëzve që mbajnë gjallë këtë vend. Kjo nuk është vetëm krizë ekonomike. Kjo është krizë e ndërgjegjes”, ka shkruar Ibrahim. Ai shton se aty ku dikur kishte

shpresë, sot ka heshtje. “Aty ku kishte prodhim, sot ka dry. Dhe më e dhimbshmja nga të gjitha - aty ku kishte marrëdhënie, besim, bashkëpunim - sot ka lot të fshehur dhe punëtorë që kthehen në shtëpi me duar bosh”, u shpreh Ibrahim. Ibrahim ka bërë thirrje për veprime duke shtuar “Zgjuhu Kosovë. Sepse ata që po largohen sot, janë po ata që na mbajtën në këmbë dje. Dhe pa ta, nesër mbetemi bosh”.

Rinin takimet në Bruksel për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Zëvendëskryeministri në detyrë i Kosovës, Besnik Bislimi, ka udhëtuar për në Bruksel. Ai do të ketë takim lidhur me procesin e dialogut me Serbinë, ka njoftuar zëdhënësi i BE-së, Anouar El Anouni, në një konferencë për medie të hënën. “Ajo çka mund të them është se takimi

ishte thirrur në nivel të kryenegociatorëve. Takimi me palën e Kosovës zhvillohet me pjesëmarrjen e zëvendëskryeministrit Bislimi. Pala serbe pritet të mbërrijë nesër. Kjo është ajo çka mund të themi aktualisht dhe do t’ju lajmërojmë nëse kemi informacione të tjera”, ka deklaruar ai.

Ky është takimi i parë i kryenegociatorëve nga Kosova dhe Serbia në Bruksel që nga emërimi i Peter Sorensenit i dërguar i posaçëm për dialog në vend të Miroslav Lajçakut. Që nga shtatori i vitit 2023 në Bruksel nuk është zhvilluar asnjë raund i dialogut politik, por ka pasur vetëm bisedime në nivel të kryenegociatorëve.



E gjithë kjo ndodhi për shkak të krizave dhe tensioneve në veri të Kosovës.

Kosova dhe Serbia, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, në shkurt të vitit 2023 kanë arritur marrëveshjen bazë në Bruksel, ndërkaq pas një muaji, më 18 mars, janë pajtuar për aneksin e zbatimit të saj në Ohër të Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, zbatimi i saj ende nuk shihet në horizont.

BIZNESET E MËDHA KALOJNË NË TREGUN E HAPUR TË ENERGJISË

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Zyra e Rregullatorit për Energji ka njoftuar se më 1 qershor bizneset e mëdha kanë kaluar në tregun e hapur të energjisë. “Me sukses, të gjitha që kanë lidhur kontrata me furnizuesit kanë dalë në tregun e hapur. Ato që nuk kanë lidhur kontratë, kanë kaluar automatikisht te Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, tha për “Radion Evropa e Lirë”, kryesuesi i bordit të ZRRE-së, Ymer Fejzullahu. Megjithatë, Fejzullahu nuk dha shifra se sa kompani, nga rreth 1 300 që preken nga vendimi i liberalizimit të tregut, kanë lidhur kontrata dhe sa të tjera do të furnizohen me rrymë nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Ndërkaq, më vonë gjatë të dielës, ZRRE-ja tha se për të gjithë konsumatorët që janë duke u furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, energjia është siguruar përmes bursës shqiptare (APLEX). Kjo zyrë tha, po ashtu, se liberalizimi i tregut është hap thelbësor “drejt përmbushjes së standardeve evropiane dhe integritimit të plotë të tregut të energjisë së Kosovës në tregun rajonal dhe atë evropian”.

Ndërkaq ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, njoftoi se KEK-u po siguron energji nga ALPEX me një çmim mesatar prej 64.55 eurosh për megavat. “Nga ZRRE-ja presim ta monitorojë tregun me përpikëri dhe t’i ndihmojë të gjitha palët për një tranzicion sa më të lehtë, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar t’i ndihmojë ndërmarrjet që tashmë kanë dalë në treg për t’i bërë zgjidhjet më të favorshme për biznesin e tyre”, ka shkruar ajo në “Facebook”.

Por, nga Oda Ekonomike thonë se kësaj shume i shtohen “edhe rreth 30 euro për tarifat e rrjetit (KOSTT dhe KEDS), si dhe kosto shtesë për administrim, rrezikshmëri dhe marzhë fitimi, për të cilat nuk dihet sa janë saktësisht”. “Kjo situatë krijon pasiguri të plotë, madje edhe kur bëhet fjalë për furnizim nga Furnizuesi i Fundit”.

Sipas një raporti që më herët është publikuar nga ZRRE-ja, bizneset sa ishin në tregun energjetik me çmime të rregulluara, gjatë ditës (tarifa e lartë) për një megavat energji në orë kishin paguar rreth 140 euro, kurse gjatë natës (tarifa e ulët) rreth 69 euro.

Po sipas ZRRE-së, çmimi mesatar i energjisë për konsumatorët jofamiljarë vitin e kaluar ka qenë 9.30 centë kilovati në orë apo 93.0 euro për megavat në orë.

Kalimi në tregun e hapur, përkatësisht në tregun me çmime të parregulluara për furnizim me energji, po bëhet pavarësisht prej kundërshtimeve të shumta nga ana e bizneseve. Pas hyrjes në fuqi të vendimit, Aleanca Kosovare e Bizneseve tha se ZRRE-ja ka vepruar në mënyrë të njëanshme, pa transparencë “dhe duke shpërfillur realitetin ekonomik të vendit”. “Ky vendim është goditje direkte ndaj sektorit privat, që është shtylla kryesore e ekonomisë së



Kosovës dhe rrezikon qindra vende pune, ul konkurrencën dhe nxit rritjen e çmimeve për konsumatorët”, u tha në reagim. Kjo aleancë kërkoi shtyrjen e vendimit për një vit, duke paralajmëruar se bizneset do t’i vazhdojnë kundërshtimet edhe përmes protestave.

Po një ditë më parë kreu i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, tha se bizneset nuk janë kundër tregut të hapur, por kërkoi që vendimi të shtyhej për një kohë, në mënyrë që ky kalim në tregun e liberalizuar të përgatitej më mirë. Ai paralajmëroi se pa përgatitje të duhura, vendimi i ZRRE-së do të ketë efekte negative për bizneset, ekonominë dhe qytetarët e Kosovës.

Vendimi i ZRRE-së

Sipas këtij vendimi të ZRRE-së, të gjitha bizneset e mëdha, me mbi 50 punëtorë ose me qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro, është dashur të zgjedhin vetë një kompani të licencuar për furnizim me energji elektrike.

Nëse nuk kanë arritur të përzgjedhin, këto biznese nga 1 qershori kanë kaluar automatikisht në tregun e hapur, ku furnizimi bëhet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF), por me çmime të përcaktuara nga tregu. FMF-ja mund të furnizojë vetëm dy muaj më energji kompanitë dhe nëse pas kësaj periudhe ato që nuk gjejnë furnizues, rrezikojnë të shkëputen nga rrjeti energjetik. Aktualisht në Kosovë janë të licencuara 21 kompani tregtare për

furnizim me energji, ndërsa një kompani tjetër është në proces licencimi.

Megjithatë, sipas ministres së Ekonomisë, Artane Rizvanolli, vetëm pesë prej tyre kanë paraqitur deri tani oferta konkrete për sektorin e bizneseve.

Pjesë e këtyre kompanive është edhe Operatori për Furnizim me Energji, KESCO, që aktualisht furnizon shumicën e konsumatorëve familjarë dhe industrialë në vend. “Radio Evropa e Lirë” ka biseduar me disa biznese gjatë kësaj jave dhe asnjëra prej tyre nuk ka nënshkruar marrëveshje me kompanitë e licencuara. Sipas tyre, vetëm KESCO ka dhënë një ofertë me çmim deri në 260 euro për megavat - çmim që ata e konsiderojnë të papërballueshëm. KESCO nuk e ka konfirmuar zyrtarisht këtë çmim.

Për shkak të çmimit të lartë të energjisë dhe mungesës së ofertave nga kompanitë furnizuese, më 29 maj qindra biznese protestuan duke bllokuar për dy orë tri hyrjet kryesore të Prishtinës me mauna dhe automjete.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, deklaroi se bizneset po kërkojnë që zbatimi i vendimit të shtyhet për një vit, meqë “nuk janë bërë përgatitjet e nevojshme për këtë ndryshim të madh”.

Nga ana tjetër, Njazi Musliu, pronar i kompanisë “Eurometal” në Ferizaj, që ka afër 90 punëtorë, e ka cilësuar vendimin si shkatërrues për biznesin e tij.

Në protestën e së enjtes ai theksoi se ky zhvillim e bën të pamundur konkurrencën në tregjet e rajonit dhe Evropës, ku kompania e tij

është e pranishme me produkte të përpunimit të metalit. “Do të detyrohem i ulim numrin e punëtorëve nën 50, vetëm që të mos hyjmë në tregun e hapur në mënyrë që t’i ruajmë klientët me çmimet aktuale”, deklaroi ai për “Radion Evropa e Lirë”. Por, kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, e kritikoi Odën Ekonomike, duke thënë se “nuk ka bërë asgjë” për t’i përgatitur bizneset për këtë proces.

Nga ana tjetër, ZRRE-ja ka thënë të premtën për “Radion Evropa e Lirë”, se disa biznese private dhe ndërmarrje publike tashmë kanë nënshkruar kontrata me kompani të licencuara për furnizim me energji elektrike.

Në Kosovë, liberalizimi i tregut të energjisë është paraparë me Ligjin për Energjinë Elektrike të miratuar në vitin 2016, por zbatimi i tij është shtyrë për shkak të rrethanave të ndryshme.

Rritja e energjisë, AKB-ja kërkon pezullim të vendimit ose përshkallëzim të protestave

Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) shpreh kundërshtimin e vendosur dhe të plotë ndaj vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), i cili nga e diela ka hyrë në fuqi dhe ka detyruar afër 1 300 biznese në Kosovë të kalojnë në tregun e lirë të energjisë elektrike, me çmime shumë më të larta dhe të papërballueshme. Ky vendim, i cili është marrë kundër komunitetit të biznesit dhe pa asnjë analizë të ndikimit ekonomik, do të sjellë pasoja të

rënda për ndërmarrjet vendore. “Nga sot, bizneset do të përballen me një rritje ekstreme të çmimit të energjisë - mbi 250 % më shumë se një vit më parë. ZRRE ka vepruar në mënyrë të njëanshme, pa transparencë dhe duke shpërfillur realitetin ekonomik të vendit. Ky vendim është goditje direkte ndaj sektorit privat, që është shtylla kryesore e ekonomisë së Kosovës, dhe rrezikon qindra vende pune, ul konkurrencën dhe nxit rritjen e çmimeve për konsumatorët. Ky vendim ka nxitur reagime të forta nga komuniteti i biznesit dhe ka sjellë protesta të qindra ndërmarrësve dhe punëtorëve në mbarë vendin”, është thënë në reagimin e AKB-së.

Në emër të bizneseve vendore, AKB-ja kërkon anulimin e menjëhershëm të vendimit të ZRRE-së ose, së paku, shtyrjen e tij për një periudhë prej një viti; Fillimin e një dialogu të hapur dhe të sinqertë me institucionet shtetërore dhe përfaqësuesit e biznesit për të ndërtuar një zgjidhje të qëndrueshme dhe të drejtë; Përgjegjësi institucionale nga ZRRE për dëmin që u shkaktohet bizneseve dhe ekonomisë së vendit; Nëse ky vendim nuk pezullohet, bizneset do ta vazhdojnë kundërshtimin në të gjitha format demokratike e ligjore, përfshirë protesta të organizuara në edhe në mbarë Kosovën. Protesta nuk është zgjedhja jonë, por është bërë e pashmangshme; Ne nuk do të heshtim përballë padrejtësisë! Do ta mbrojmë punën tonë, të ardhmen tonë dhe të drejtën për të zhvilluar një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese.

“RRJETA E MERIMANGËS”. SI NJERËZIT E ZELENSKIT SHKATËRRUAN FLOTËN E BOMBARDUESVE TË PUTINIT

Ishte një operacion super sekret, kishte rreth 18 muaj që planifikohej. Me emrin e koduar “Rrjeta e Merimangës”, ai u ekzekutua me efekt shkatërrues pasditen e djeshme dhe ishte njëkohësisht i guximshëm dhe gjenial.

Dhe, siç tha Volodymyr Zelensky, vetëm disa orë para se delegacionet ukrainase dhe ruse të takohen për bisedime në Stamboll sot, sulmi ndaj bombarduesve bërthamorë të pazëvendësueshëm të Vladimir Putinit “do të shkruhet padyshim në librat e historisë”. Sulmi u krye pikërisht 29 vjet nga dita kur Ukraina i dorëzoi Rusisë dhjetëra nga të njëjtët bombardues strategjikë, së bashku me 2,000 koka bërthamore strategjike dhe 176 raketa balistike ndërkontinentale, në këmbim të një premtimi për të mos u sulmuar, sipas Memorandumit të Budapestit.

Në sulmin e tyre më të guximshëm deri më tani në këtë luftë, forcat speciale ukrainase fillimisht kontrabanduan 117 dronë kamikazë të kontrolluar me pamje të drejtpërdrejtë (FPV) — të cilët u japin pilotëve kontroll në kohë reale — në territorin rus.

Pastaj erdhën kabina druri të lëvizshme, çatitë e të cilave kishin ndarje të fshehta ku ishin fshehur këto armë të vogla fluturuese. Ato u ngarkuan në kamionë civilë që shkonin në territorin armik, me shoferë vendas që duket se nuk ishin në dijeni se ç’po transportonin.

Në fund, pasditen e djeshme, me të gjithë kamionët brenda rrezes së pesë bazave ajrore nga veriu i Rusisë deri në Siberi mijëra kilometra larg Ukrainës, ata goditën.

Çatitë e kabinave prej druri u hapën nga distanca dhe dronët FPV nisën fluturimin.

Me ndihmën e kamerave të vendosura përpara, dronët e armatosur me raketa shkuan drejt bombarduesve të kushtueshëm rusë.

Pamjet tregonin avionë të shkatërruar në flakë dhe mbrëmë, burime të sigurisë ukrainase pretendonin se kishin asgjësuar 41 avionë me një vlerë afro 1.8 miliardë Euro.

Mes tyre janë bombarduesit bërthamorë Tu-95 dhe Tu-22M, si dhe avioni i zbulimit A-50 “Mainstay”, me një vlerë rreth 290 milionë Euro, që përdoret si radar dhe qendër komande, dhe për të cilin Rusia besohet të ketë vetëm rreth dhjetë ekzemplarë. “Mainstay” janë kritikë për të



koordinuar avionët luftarakë dhe mbrojtjen ajrore ruse, që do të thotë se kjo goditje do ta ketë dëmtuar rëndë përpjekjen luftarake të Putinit. Moska ka ndaluar prodhimin e këtyre avionëve prej kohësh, që do të thotë se, nëse konfirmohet, këto mjete nuk mund të zëvendësohen. Janë vetëm rreth 120 Tu-95 dhe Tu-22M në gjendje pune, dhe ata janë jetikë për sulmet e përnatshme të Putinit ndaj Ukrainës.

Ata ishin zhvendosur në baza ajrore mijëra km larg Ukrainës, jashtë rrezes së raketave Storm Shadow dhe ATACMS të furnizuara nga Perëndimi, të cilat kanë një rreze deri në 300 km.

Dronët FPV, të cilët mund të arrijnë vetëm 20 km, do të kishin qenë gjëja e fundit që do të pritej nga rusët. Zelensky mbrëmë deklaroi se operacioni kishte shkatërruar një të tretën e bombarduesve strategjikë të Rusisë dhe ishte kryer nën hundën e shërbimeve sekrete të saj.

Ai tha: “Më interesante është që ‘zyra’ e operacionit tonë në ter-

ritorin rus ndodhej ngjitur me selinë e FSB-së, në një nga rajonet e tyre. Në total, 117 dronë u përdorën në operacion, me një numër të barabartë operatorësh, dhe u goditën 34 për qind e mbajtësve të raketave strategjike në bazat ajrore. Ne do të vazhdojmë.”

Blogeri ushtarak Roman Alekhin tha se ky incident do të mbahet mend si “Pearl Harbor-i i Rusisë” — një referencë për sulmin japonez ndaj SHBA-së në vitin 1941 që nxitte Uashingtonin të hynte në Luftën e Dytë Botërore.

Por ekspertët gjithashtu bënë krahasime me sulmin e SAS-it në vitin 1942 në aeroportin Sidi Haneish në Egjipt, kur komandot britanike neutralizuan 40 avionë të Luftwaffes me makina xhip të armatosura me mitraloza.

Edhe pse ky sulm nuk ishte një moment vendimtar në Luftën e Shkretëtirës, ai rriti ndjeshëm moralin britanik dhe dëmtoi logjistikën e Boshtit në Afrikën e Veriut. Ajo gjithashtu ishte një nga ngjarjet kyçe që ndihmoi në

ndërtimin e statusit legjendar të SAS-it.

Ish-piloti i RAF-it dhe analisti ushtarak Mikey Kay i tha BBC-së: “Rusët nuk do ta kishin imagjinuar kurrë diçka të tillë. Dua të them, është gjeniale, po të mendosh vetëm për efektin shkatërrues që ka pasur mbi asetet strategjike të Putinit.”

Philip O’Brien, profesor i studimeve strategjike në Universitetin e St Andrews, e quajti këtë sulm “operacionin më të jashtëzakonshëm dhe të suksesshëm të luftës”.

Ai i tha The Times: “Kjo është një goditje e madhe për fuqinë ajrore strategjike të Rusisë, që është e vështirë të mbivlerësohet. Nuk e dimë se si do të reagojë Rusia, por mund të supozojmë se do të jetë e dhunshme.”

Një kanal në Telegram i quajtur Fighterbomber, që besohet të drejtohet nga kapiteni Ilya Tumanov i Ushtrisë Ruse, shkroi për sulmin: “Kjo ditë më vonë do të quhet një ditë e zezë për avionin me rreze të gjatë të Rusisë. Dhe dita nuk ka mbaruar ende.”


Zelensky, i cili thuhet se e ka mbikëqyrur këtë operacion për më shumë se një vit e gjysmë, festoi sulmin në rrjetet sociale mbrëmë.

Presidenti ukrainas shkroi: “Një rezultat i arritur vetëm nga Ukraina. Një vit, gjashtë muaj dhe nëntë ditë nga fillimi i planifikimit deri në ekzekutimin efektiv. Operacioni ynë më i gjatë.”

Ai shtoi: “Këto janë veprime të Ukrainës që padyshim do të shkruhen në librat e historisë.”

Një delegacion nga Kievi pritet të takohet me homologët e tyre nga Moska për raundin e dytë të bisedimeve të paqes në Stamboll sot, por mbrëmë nuk ishte ende e qartë nëse do të zhvillohej.

Ukraina ka thënë se propozimet e saj do të përfshijnë një armëpushim të plotë 30-ditor të ndjekur nga kthimi i të gjithë të burgosurve të të dyja palëve. Negociatorët gjithashtu duan që rreth 20,000 fëmijë ukrainas të rrëmbyer nga Rusia të kthehen në atdhe përpara se Zelensky dhe Putini të takohen. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Paraqiten prurjet e reja - Krasniqi, Haxha e Raçi: Forca Kosova

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Federata e Futbollit e Kosovës ka paraqitur zyrtarisht tri prurjet më të reja në Kombëtaren A përmes një videoje emocionuese të publikuar në rrjetet sociale. Bëhet fjalë për Bledian Krasniqin,

Florian Haxhën dhe Ron Raçin, tre futbollistë të rinj që tashmë do ta veshin fanellën dardane në ndeshjet e muajit qershor ndaj Armenisë dhe Komoreve. “Unë jam Bledian Krasniqi, lojtari më i ri i Kosovës, dhe jam shumë

krenar që do të luaj për fanellën e Kombëtares së Kosovës. Forca Kosova!”, tha Krasniqi. Ndërsa Florian Haxha shfaqti emocione për thirrjen nga Kosova: “Ka me luftuar për fanellën e Kosovës. Forca Kosova!”, tha ai shkurt, por

me plot vendosmëri. Edhe talenti i Prishtinës, Ron Raçi, shprehu emocionet: “Ta veshi këtë fanellë është një ëndërr e bërë realitet për mua”, u shpreh mbrojtësi premtues. Kosova po përgatitet për sfidat e ardhshme dhe



prurjet e reja janë një sinjal i qartë për rifreskimin e ekipit dhe ndërtimin e një brezi të fortë për të ardhmen.

Beka dhe Korenica: Duam t’i fitojmë dy ndeshjet miqësore

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll i ka nisur përgatitjet në Kampin Nacional në Hajvali për dy ndeshjet miqësore të muajit qershor. “Dardanët” do të përballen me Armeninë më 6 qershor në stadiumin “Fadil Vokrri”, ndërsa tri ditë më vonë në të njëjtin stadium luajnë kundër Komoreve. Përzgjedhësi Franco Foda ka pasur në dispozicion pothuajse të gjithë ekipin, me përjashtim të Ismet Lushakut, Lumbardh Dellovës, Florent Hadërgjonajt dhe Leart Paqaradës, të cilët kanë punuar në mënyrë individuale në hotel për arsye rikuperimi.

Mbrojtësi i Luzernit, Ismajl Beka, pas stërvitjes u shpreh i motivuar për miqësoret e radhës. “Jam shumë i lumtur për ftesën dhe seanca e parë stërvitore ka qenë shumë e mirë. Jemi stërvitur mirë dhe atmosfera është shumë pozitive me të gjithë bashkëlojtarët. Shpresoj që kjo atmosferë të vazhdojë edhe në ditët në vijim. Jemi shumë të motivuar sepse e dimë çfarë cilësie kemi - e kemi dëshmuar edhe kundër Islandës dhe me promovimin në Ligën B. Shpresoj që do t’i fitojmë të dyja miqësoret dhe të arrijmë rezultate pozitive”, ka thënë Beka. Ndërkaq mesfushori rahovecas i



skuadrës rumune Cluj, Meriton Korenica, u shpreh i gëzuar për rikthimin në ekipin përfaqësues. “Jam shumë i lumtur që jam

sërish pjesë e Kombëtares. Shpresoj që në këto dy ndeshje ta japim maksimumin dhe unë do të jem gjithmonë i gatshëm

për fanellën dardane. Dua që në ekipin kombëtar të vazhdoj kontinuitetin që e kam pasur me klubin. Këto dy miqësore janë shumë të rëndësishme për të na motivuar edhe më shumë, sepse në kualifikimet e shtatorit duhet ta japim maksimumin. Shpresoj që secili nga ne të japë gjithçka nga vetja, sepse ia kemi borxh shtetit tonë”, ka thënë Korenica. Kosova synon që me këto miqësore të përgatitet sa më mirë për ciklin kualifikues të Botërorit, që do të fillojë në muajin shtator. Kujtojmë që “Dardanët” janë pjesë e Grupit B dhe do të zhvillojnë ndeshje në sistemin vajtje-ardhje kundër Suedisë, Zvicrës dhe Sllovenisë.

Përfundon spektakli i pingpongut botëror në Prishtinë

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Për katër ditë me radhë Pallati i Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë u shndërrua në epiqendër të pingpongut botëror, duke mirëpritur sportistë nga e gjithë bota në garat prestigjioze WTT Youth Contender Prishtina 2025. Të pranishëm në ceremoninë përmbyllëse ishin edhe figura të rëndësishme të sportit në vend, presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, dhe drejtori i Drejtorisë së Sportit në



komunën e Prishtinës, Kushtrim Mushica, të cilët dhanë çmime për finalistët dhe kampionët.

Garat e zhvilluara sollën përballje të forta, emocione të veçanta dhe çaste të paharrueshme për sportdashësit dhe pjesëmarrësit. Në fund u shpallën fituesit në tri kategori: U11, U15 dhe U19. Në këtë kategori dominuan sportistët nga Katari, duke fituar me rezultat të ngushtë 3:2. Racha Loghraibi zhvilloi një përballje emocionuese me greken Kleio Madesi, e cila ishte shumë afër fitores, por nuk arriti ta

përmbyste rezultatin. Në anën tjetër, për Rabeah Al-Kučëri kjo finale kishte një domethënie të veçantë – pas përpjekjesh të shumta për të arritur një trofe, më në fund arriti ta mposhtë Taavi Samaraweeran nga Sri Lanka dhe të sigurojë fitoren e parë në karrierë, raporton “KosovaPress”. Në kategorinë U15, te femrat u përballën dy lojtare nga Taipei, Lin Wan-Rong fitoi bindshëm 3:0 ndaj Li Jen Yueh, ndërsa te meshkujt, Malik Severinsen nga

Danimarka mposhti me rezultat të pastër 3:0 gjermanin Jeffrey Wei. Në kategorinë U19 dominoi Republika e Koresë. Te meshkujt, Kwon Hyuk shënoi një fitore të sigurt 3:0 ndaj italianit Danilo Faso. Te femrat, Yoo Yerin triumfoi me rezultat 3:1 ndaj Syndrela Das nga India. Edhe sportistët e Kosovës treguan paraqitje të denja dhe përkushtim të madh, ndonëse nuk arritën të sigurojnë ndonjë çmim këtë herë.

De Biasi për ndeshjen ndaj Serbisë: Mos bëni luftë politike, bëni luftë futbollit

TIRANË, 2 QERSHOR - Ish-trajneri i Kombëtares shqiptare, Gianni De Biasi, foli për përballjen e 7 qershorit ndaj Serbisë. De Biasi jo vetëm që ka shprehur përkrahje të plotë për kuqezinjët, por ka dhënë edhe një mesazh të qartë: “Mos bëni luftë politike, bëni luftë futbollit! Do të jem në Arenën

Kombëtare. Tifozët ta çojnë skuadrën drejt fitores”. De Biasi ka thënë se do ta ndjekë ndeshjen nga stadiumi dhe u bëri thirrje tifozëve të jenë në krah të skuadrës, pa u përfshirë në tensione të kota: “T’i marrim tri pikët dhe të harrojmë pjesën tjetër, që nuk vlen për asgjë”. Duke folur për ndeshjen në

Beograd gjatë kohës kur ishte trajner i Shqipërisë, De Biasi ka thënë: “Nuk ishte më ndeshje futbollit. Ishim duke luajtur një ndeshje të barabartë, kishim raste për të shënuar, pastaj tifozët hynë në fushë, gjyqtari na çoi në dhomat e zhveshjes e aty gjithçka përfundoi”. De Biasi vlerësoi nivelin e



tanishëm të Kombëtares: “Sot kemi shumë lojtarë që luajnë në

Serinë A dhe në kampionatet më të forta të Evropës. Në kohën time ishin vetëm dy ose tre. Sot kemi lojtarë më të mirë se në kohën time, kemi cilësi dhe përvojë. Këta lojtarë nuk kanë nevojë për leksione. Duhet të jenë skuadër dhe të luftojnë deri në sekondën e fundit”, ka deklaruar De Biasi në A2 CNN.

Rosbergu: Verstappenin meritonte flamurin e zi për incidentin me Russellin

Madrid, 2 qershor - Max Verstappenin e mbylli në vendin e dhjetë garën e zhvilluar ditën e diel në Spanjë, me një penalitet prej 10 sekondash. Edhe pse u shpall “piloti më i mirë i garës”, ajo u prish në 10 xhirot e fundit, kur në pistë hyri makina e

sigurisë. Kampioni i botës në Formula 1 ishte në vendin e tretë deri në momentin që u largua makina e sigurisë. Por, pasi humbi kontrollin e njëvendëshes së tij, ai pati dy kontakte të menjëhershme në pak metra, me Leclercun dhe

Russellin. Me pilotin britanik të Mercedesit pati edhe një kontakt tjetër një xhiro më vonë, kur iu kërkua ta hapte krahun, duke e përplasur qëllimisht. Një veprim i konsideruar i gabuar nga komisarët, që e penalizuan me

10 sekonda. Nico Rosberg, duke folur për “Sky Sport”, ka thënë se komisarët u treguan të butë ndaj Verstappenit: “Manovra e Max është vërtet e keqe. Ai meriton flamurin e zi, pasi u përplas me Russellin me qëllim. Nuk ka zgjidhje tjetër”.



Portugalia e fitoi Euro U17 në Shqipëri, Duka: Një Evropian që na bëri krenarë

TIRANË, 2 QERSHOR - Portugalia ka fituar titullin kampion Evrope U17 për të shtatën herë. Duke e uruar për trofeun, presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, thotë se ky event sportiv pati një rëndësi të madhe për Shqipërinë dhe FSHF-në. Në një postim në rrjetet sociale, Duka falënderon të gjitha ekipet pjesëmarrëse dhe të gjithë ata që u bënë pjesë e organizimit të këtij Evropiani që u zhvillua nga 11 maji deri më 1 qershor. “Një Evropian që na bëri krenarë! Evropianit të parë në Shqipëri i erdhi fundi dhe në shtëpinë tonë, në Arenën Kombëtare, ishte Portugalia që ngriti në qiell trofeun dhe festoi titullin kampion Evrope U17 për të shtatën herë. Urime Portugalisë fituese, në një kompeticion ku fituam shumë edhe ne si Federatë duke shtuar në portofolin tonë të organizimeve një tjetër event ndërkombëtar, si shqiptarë që shijuan një Evropian fantastik me ndeshje mjaft të bukura, si ekip që fitoi përvojë me të parën



pjesëmarrjeje në një nivel të tillë. Faleminderit të gjitha ekipeve pjesëmarrëse – Portugalisë kampione, Kombëtares sonë, Francës, Italisë, Belgjikës, Gjermanisë, Anglisë, Çekisë – për atë që dhanë në fushë. Faleminderit të gjithë atyre që ishin pjesë e organizimit të këtij Evropiani në prapaskenë, punonjësit e Federatës së Futbollit, bashkëpunëtorët tanë në Elbasan, Durrës e Rrogozhinë, Bashkitë e këtyre

qyteteve, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe çdo institucion shtetëror që ishte bashkë me ne për ta bërë këtë Evropian të paharrueshëm. Faleminderit të gjithë tifozëve, që iu përgjigjen ftesës tonë për të qenë pjesë e një eventi që ofroi emocione e gola të bukur, nga ndeshja e parë tek e fundit. Portugalia e nisi me fitore në ‘Arenën Kombëtare’ dhe e mbylli në të njëjtën mënyrë, duke merituar gjithçka! Urime!”, ka shtuar Duka.

Amir Rrahmani, mbrojtësi më i mirë i Serisë A dhe i katërti në botë

NAPOLI, 2 QERSHOR - Amir Rrahmani është shpallur mbrojtësi më i mirë i Serisë A sipas renditjes së fundit të publikuar nga CIES (Qendra Ndërkombëtare për Studime Sportive), ndërsa i katërti në botë. Ky institut ka përpiluar një listë me 20 lojtarët më influentë në botë për secilin rol, duke analizuar 60 kampionate në të gjithë globin. Përzgjedhja e lojtarëve është bërë duke u mbështetur në të dhëna të partnerëve të observatorit dhe duke marrë parasysh edhe minutat e luajtura. Gjashtë aspektet kryesore të lojës që merren në konsideratë janë: duelet ajrore, mbrojtja në tokë, shpërndarja e pasimeve, avancimi me topin, krijimi i rasteve për gol dhe finalizimi. Në listën e mbrojtësve më të mirë, në krye qëndron ylli i Liverpoolit, Virgil van



Dijk. Podiumi plotësohet nga Aurelien Tchouameni i Real Madridit, që shpesh luan edhe si mesfushor, dhe William Saliba i Arsenalit. Amir Rrahmani, kapiteni i Kosovës dhe mbrojtësi i Napolit, renditet i katërti në këtë klasifikim, një super vlerësim për lojën e prishtinasit. Ndërkohë, vendin e tetë e zë

Alessandro Bastoni i Interit, kurse në vendin e 17 është Berat Gjimshiti, shtylla e mbrojtjes së Atalantës. Ky vlerësim i CIES konfirmon nivelin e lartë të mbrojtësve shqiptarë, duke e vendosur Rrahmanin mes më të mirëve në botë dhe duke nderuar kontributin e Gjimshitit tek Atalanta.

SHKURT

Quni paraqet FHK-në në samitin e rëndësishëm në Budapest

Administratori i Garave në Federatën e Hendbollit të Kosovës, Nikollë Quni, në fundjavë mori pjesë në një aktivitet shumë të rëndësishëm. Ai e paraqiti federatën tonë në Samitin e Ligave Evropiane të Hendbollit për Femra (WEHL). Ky Samit është mbajtur këtë fundjavë në Budapest të Hungarisë, në kuadër të Final4 të Ligës së Kampionëve për hendbolliste. Pjesë e Samitit ishin përfaqësues të federatave nacionale nga shumë vende anëtare të EHF-së. Gjatë Samitit janë shtjelluar tema të ndryshme që kanë të bëjnë me hendbollin e femrave si: mbajtja e vazhze dhe grave në hendboll, zhvillimi i ligave dhe klubeve dhe shumë tema të tjera. Në diskutimet me pjesëmarrësit e tjerë dhe para të pranishmëve të shumtë nga bota e hendbollit, Quni ka paraqitur shifra dhe fakte lidhur me hendbollin e femrave në vendin tonë si dhe synimet e planet për të ardhmen. Zyrtari i FHK-së ka përcjellë nga afër edhe ndeshjet e turneut final të Ligës së Kampionëve për hendbolliste.

Southamtoni sërish e dëshiron Bojën

Sulmuesi Armando Broja nuk arriti të lë gjurmë në skuadrën e Evertonit dhe është rikthyer sërish në shtëpi, te Chelsea, por as në Londër nuk pritet të qëndrojë gjatë, pasi trajneri Marseca nuk e sheh pjesë të planeve të tij. Dëshira e drejtuesve të klubit është ta shesin Brojën, por nuk ndryshojnë qëndrim në lidhje me vlerën e kartonit të tij, kërkojnë të paktën 30 milionë euro. Sipas medieve angleze, në horizont për Brojën ka dalë sërish ish-ekipi i tij, Southampton. Në radhët e “Shenjtorëve”, Broja kaloi periudhën e tij më të mirë në Premierë Ligë ku gjatë sezonit 2021/22 luajti 38 ndeshje, duke shënuar 9 gola dhe dhuruar 2 asistime. Southamptoni ra një kategori më poshtë këtë sezon. Nga viti i ri do të luajë në Championship, por synon të rikthehet sa më shpejt në elitë, për këtë arsye është vënë në kërkim të një sulmuesi.

Al Nassri përgatit kontratë të re për Ronaldon

Al Nassr ka bërë gati një kontratë të re për Cristiano Ronaldon, me synimin për ta mbajtur yllin portugez përtej marrëveshjes aktuale. Klubi saudit shpreson t'i paraqesë planet e tij shumë shpejt dhe të marrë një përgjigje të menjëhershme, shkruan gazetari i njohur Fabrizio Romano. “Al Nassr është gati t'i prezantojë Cristianos projektin e ri dhe po shpreson të arrijë një marrëveshje të re për ta vazhduar bashkëpunimin. Klubi po përgatit disa ndryshime të rëndësishme për ta bindur Ronaldon dhe për ta finalizuar rinovimin e kontratës”, shkruan Romano. Përveç rinovimit të Ronaldos, Al Nassr ka vënë në shënjestër disa përforcime për afatin kalimtar të verës. Sulmuesi kolumbian i Liverpoolit, Luis Diaz, dhe mbrojtësi sllovak i Feyenoordit, David Hancko, janë mes objektivave të klubit për ta forcuar skuadrën.

Liverpoolit i refuzohet oferta prej 135 milionë eurosh për Wirtzin


Liverpooli ka marrë një “jo” nga Bayer Leverkuseni pas ofertës së parë për Florian Wirtz. Sipas gazetës gjermane “Bild”, oferta prej 135 milionë eurosh e Liverpoolit për Wirtz është refuzuar nga

Leverkuseni. Klubi anglez po përpiqet të negociojë një marrëveshje më të favorshme financiarisht, ndërsa Leverkuseni mbetet i vendosur për të marrë 150 milionë euro. “Mbetet e paqartë nëse

diferenca prej 15 milionë eurosh do të mbulohet përmes një pagese fikse apo bonuseve lehtësisht të arritshme”, shkruan “Bild”. Megjithatë, pavarësisht prej këtij ngërçi, Leverkuseni nuk beson se

marrëveshja do të dështojë. Liverpooli thuhet se ka marrë dritën e gjelbër nga pronarët për ta përmbushur kërkesën financiare prej 150 milionë eurosh. Negociatat janë duke vazhduar, por për momentin

nuk është diskutuar për përfshirjen e ndonjë lojtari në marrëveshje. Wirtz shihet si objektivi madhor për “The Reds”, ndërsa Bayer po luan me kujdes për ta ruajtur vlerën e tij në treg.



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Granit" shpk Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Shfrytëzimin, Thërmimin dhe Seperimin e Gurit Gëlqeror në vendburim në Z.K. Lubozhdë dhe Cerrcë, Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.07.2025 në ora 10:00 në Shtëpinë e Kulturës, kati i dytë, rruga Skënderbeu nr. 54 në Istog, do të organizohet debat publik nga Kompania "Granit" shpk Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGZcHhRjI1OHhxdmNpUWJJCUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Granit" shpk Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor, – për Shfrytëzimin, Thërmimin dhe Seperimin e Gurit Gëlqeror në vendburim në Z.K. Lubozhdë dhe Cerrcë, Istog.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

"Istanbul Baklava" SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 811937955, Gjilan me pronar Avni Kamberi dhe Kasim Ivgen bënë shpallje në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 350.000 Euro në 170.000.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Në kujtim të babait tonë të dashur



Ilaz (Vesel) Krasniqi
(20. 9. 1943 - 2. 6. 2008)

Më 2 Qershor 2025, bëhen 17 vite nga ndarja jote nga kjo jetë, por kujtimi yt është i gjallë dhe i pashlyeshëm në zemrat tona.

Na mungon buzëqeshja jote, fjalët e urta dhe dashuria pa kushte që na ke dhuruar.
I drejtë dhe gjithmonë pranë nesh – as koha, as largësia nuk e zbehin mungesën tënde.

Të duam dhe do të kujtojmë gjithmonë.

Me mall e dashuri: Djemt, vajzat, nipat dhe mbesat.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L